



Prishtinë, 24 qershor 2008
Kodi i ZRRE: D_087_2008

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, duke u bazuar në

1. Dispozitat e Neneve 15 dhe 26 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë të amendamentuar me Ligjin Nr.03/L-080;
2. Kërkesën e NQ Gjakova SH.A për derrogim në zbatimin e Neneve 35.2 dhe kërkesën për amendamentimin e nenit 32.1 "Grup i Kualifikuar" lidhur me ndryshimin e përqindjes së pagesës, të Rregullit mbi Shkycjen dhe Rikycjen e Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë në Kosovë, të datës 18 janar 2008, **në seancën e mbajtur më 24 qershor 2008 ka nxjerrë këtë:**

VENDIM

- I. **Aprovohet kërkesa e NQ Gjakova SH.A për derrogim të afatit përcaktuar me Nenit 35.2 të Rregullit mbi Shkycjen dhe Rikycjen e Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë në Kosovë.**
 - II. **I lejohet NQ Gjakova SH.A të zbatojnë shkycje kolektive nga data e lëshimit të këtij vendimi deri më 31 mars 2009.**
 - III. **Refuzohet kërkesa e NQ Gjakova SH.A për amendamentimin e nenit 31.1 "Grup i kualifikuar" lidhur me ndryshimin e përqindjes së pagesës nga 90% në 50%.**
1. Në janar të vitit 2008 NQ Gjakova SH.A ka bërë kërkesë për zgjatjen e afatit për shkycje kolektive të përcaktuar me nenin 35.2 të Rregullit për shkycjen dhe rikycjen e konsumatorëve në sektorin e energjisë në Kosovë.
 2. ZRRE ka vlerësuar kërkesën dhe argumentet e ndërmarrjes në fjalë dhe ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
 3. Të gjitha dispozitat tjera të Rregullit mbi Shkycjen dhe Rikycjen e konsumatorëve në Sektorin e Energjisë në Kosovë do të mbesin në fuqi.
 4. Ky Vendim nxirret në tri gjuhë: shqip, serbisht dhe anglisht. Në rast të mospërputhjes midis gjuhëve, do të sundojë versioni në gjuhën shqipe.
 5. Pala e pakënaqur, mund të paraqesë ankesë kundër këtij Vendimi në gjykatën e juridiksionit përkatës, brenda 14 ditësh prej miratimit ose datës së publikimit të vendimit në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.
 6. Ky Vendim hyn në fuqi datën e lëshimit ose datën e publikimit në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Bordi i ZRRE-së:

Ali Hamiti, Kryesues

Theranda Beqiri, Anëtare

Nysret Avdiu, Anëtar